



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 257 Akti

Nr. 208 Vendimi
Tiranë, më 8.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në datën 7.11.2019, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Daniela Shirka**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin z. Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit znj. Daniela Shirka, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 3, dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin, në datën 15.1.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Valbona Sanxhaktari dhe Genta Tafa (Bungo). Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.1.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Shirka.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit

të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 7.9.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2019 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 29.10.2019), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka.*

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. *** prot., datë 26.7.2019.

11. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimit të pasurisë; kontrollit të figurës; dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës në datën 29.5.2019, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Shirka; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit në datën 24.10.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 25.10.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 4.11.2019.

14. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet e saj në rrugë zyrtare, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 5.11.2019, vendosi të ftojë znj. Daniela Shirka, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail* në datën 5.11.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 7.11.2019, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Daniela Shirka ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; dhe (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja.

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimi i deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, të datës 7.9.2018, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2003 - 2016, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI, ka deklaruar këto pasuri:

- **Apartament me sip. 49.67 m²**, ndodhur në ***. Bashkëpronare në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në 1/3 pjesë, blerë në vitin 1997, me palë shitëse Entin Kombëtar të Banesave. Vlera totale është 10,841 lekë. Pjesa takuese: 1/3 e pasurisë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Nga të ardhurat e prindërve.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Rezultoi se ky apartament 1+1, me adresë: Rr. “****”, p. ***, sh. ***, ap. ***, Tiranë, është blerë me kontratë shitjeje nr. ***, datë 20.11.1997, midis palës shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palës blerëse S.Sh., L.Sh., dhe Daniela Shirka. Vlera e kontratës është 10,841 lekë.

ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar me shkresat nr. ***, datë 17.10.2016, dhe nr. ***, datë 23.7.2019, që subjekti ka në bashkëpronësi së bashku me prindërit këtë pasuri dhe se zotëron 1/3 si pjesë takuese.

Kjo pasuri është deklaruar se është blerë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit në vitin 1997, në kohën subjekti nuk ka qenë në marrëdhënie pune dhe nuk ka ushtruar funksionet e magjistratit.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka marrë titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2004.

Këtë pasuri subjekti e ka deklaruar dhe në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, të paraqitur në ILDKPKI, me përshkrimin: “*shtëpi banimi 1+1, e privatizuar në bashkëpronësi rruga “****”*”.

Në përfundim nga Komisioni konstatohet se:

Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë këtë pasuri dhe vlerën e saj në deklaratën “Vetting”. Deklarimet për këtë pasuri janë në përputhje me përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë dhe dokumentet shkresor të administruar në dosje. Nisur nga fakti se kjo pasuri është blerë (me procedurë për privatizimin e banesave shtetërore) nga prindërit dhe se subjekti nuk ka qenë në funksion si gjyqtare nga Komisioni nuk kanë lindur dyshime të mëtejshme për këtë pasuri.

- **Apartament me sip. 92 m²**, ndodhur në Rr. “****”, blerë në vitin 2012. Vlera totale 6,440,000 lekë.
Pjesa takuese: ½ së bashku me bashkëshortin.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Shuma prej 3,000,000 lekësh kursime të subjektit dhe bashkëshortit nga paga ndër vite dhe shuma 3,500,000 lekë, hua e marrë nga bashkëshorti në vitin 2011.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë dhe DPPP-së.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Kjo pasuri e paluajtshme është blerë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.1.2012, me palë shitëse K.G. Apartamenti me sip. 92 m², ndodhet në Rr. “****”, p. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë,. Vlera e blerjes sipas kontratës rezulton në shumën 6,440,000 lekë (70,000 lekë/m²).

ZVRPP-ja Tiranë me shkresat nr. ***, datë 17.10.2016, dhe nr. ***, datë 23.7.2019, ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.

Ka rezultuar se për blerjen e kësaj pasurie është lidhur kontratë kapari nr. ***, datë 11.11.2011, midis subjektit dhe palës shitëse në vlerën 700,000 lekë. Kjo kontratë është deklaruar nga subjekti dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011 dhe burimi është deklaruar nga të ardhurat nga kursimet ndër vite.

Për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti ka rezultuar se:

- në vitin 2011 janë paguar 700,000 lekë nga të ardhurat;
- në vitin 2012 është shlyer pjesa tjetër në vlerën 5,740,000 lekë. Nga kjo vlera prej 3,000,000 lekësh është deklaruar si burim nga kursimet ndër vite dhe shuma prej 3,500,000 lekë është marrë hua.

Në vitin 2012 subjekti ka deklaruar të njëjtat veprime për blerjen e kësaj pasurie si në deklaratën “Vetting”. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se vlera prej 3,000,000 lekësh (duke përfshirë dhe vlerën e kaparit prej 700,000 lekësh në vitin 2011) është e mbuluar nga të ardhurat ndër vite (kursime *cash*).

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie ka marrë hua vlerën prej 3,500,000 lekë dhe konkretisht:

- Hua e marrë në shumën 2,000,000 lekë në vitin 2011 nga shtetasi B.L. Kjo hua është shlyer në datën 29.12.2013. Burimi i shlyerjes: shuma 1,850,000 lekë kursime nga

pagat dhe shuma 150,000 lekë të ardhura të përfituara nga shpronësimi i tokës në vitin 2013;

- Hua e marrë në shumën 500,000 lekë në vitin 2011 nga vëllai i bashkëshortit, z. M.K. Kjo hua është shlyer në vitin 2014. Burimi i shlyerjes: kursimet nga pagat e familjes;
- Hua e marrë në shumën 500,000 lekë në vitin 2011 nga vëllai i bashkëshortit, z. D. K. Kjo hua është shlyer e gjitha në vitin 2014. Burimi i shlyerjes: kursimet nga pagat e familjes;
- Hua e marrë në shumën 500,000 lekë në vitin 2011 nga babai i subjektit, z. S.Sh. Kjo hua është shlyer në vitin 2015. Burimi i shlyerjes: Kursimet nga pagat e familjes

Për marrjen e huave subjekti ka paraqitur në Komision deklaratat si më poshtë:

- Deklaratë noteriale, datë 31.3.2015, me deklarues z. B.K., dhe z. B.L., të cilët deklarojnë se z. B.K., ka marrë hua shumën prej 2,000,000 lekësh në vitin 2011 dhe se e ka shlyer në vitin 2013, duke mos pasur më pretendime financiare ose pasurore me njëri tjetrin. Për këtë subjekti ka paraqitur dhe dy deklarata jo noteriale të datës 15.11.2011 dhe 29.12.2013. Lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit subjekti ka paraqitur ekstrakt të QKB-së, ku rezulton se z.B.L., ushtron veprimtari tregtare, si dhe të dhëna nga “Raiffeisen Bank” për llogaritë bankare.
- Deklaratë noteriale, datë 25.3.2015, me deklarues z. B.K., dhe z. M.K., ku rezulton huaja e marrë në shumën prej 500,000 lekësh në vitin 2011 dhe e shlyer në vitin 2014. Lidhur me huadhënësin M.K., subjekti, ka paraqitur vërtetim të datës 17.10.2016, ku rezulton se të ardhurat e z. M.K., për periudhën 2008 – 2013 kanë qenë në shumën 2,665,054 lekë.
- Deklaratë noteriale, datë 25.3.2015, me deklarues z. B.K., dhe z. D.K., ku rezulton huaja e marrë në shumën prej 500,000 lekësh në vitin 2011 dhe e shlyer në dy këste në vitin 2014. Lidhur me huadhënësin D.K., subjekti, ka paraqitur vërtetime për të ardhurat nga marrëdhëniet e punës dhe llogaritë bankare.
- Deklaratë noteriale, datë 25.3.2015, me deklarues z. B.K., dhe z. S.Sh., ku rezulton huaja e marrë në shumën prej 500,000 lekësh në vitin 2011. Lidhur me huadhënësin S.Sh., subjekti, ka paraqitur vërtetime lidhur me të ardhurat nga marrëdhëniet e punës dhe pensioni si ushtarak.

Lidhur me këto hua ILDKPKI-ja ka deklaruar se: *“Në lidhje me huamarrjet në vlerën totale prej 3,500,000 lekësh, subjekti ka paraqitur deklaratat noteriale, dokumentacion justifikues në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësve. Mënyra e marrjes dhe likuidimi i tyre jashtë sistemit bankar”*.

Arsyetimi ligjor

Deklarimi i subjektit për këtë pasuri të bërë në deklaratën “Vetting”, lidhur me vlerën e pasurisë, burimin e krijimit dhe hua të marra dhe të shlyera më pas, përputhen me deklarinin e bërë në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI.

Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shpronësimi për interes publik, është konfirmuar me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë të datës 20.3.2012 dhe veprimet bankare të datës 12.7.2013, për tërheqjen e shumës së kompensimit financiar nga bashkëshorti i subjektit. Kompensimi financiar si rezultat i shpronësimit ka qenë në emër të nënës së bashkëshortit, për

shpronësimin e një sipërfaqe tokë 2.900 m² në vlerën totale 482,987 lekë. Marrja e vlerës së deklaruar nga bashkëshorti i subjektit si rezultat i shpronësimit (1/3 e vlerës) ka ardhur si rezultat i përfitimit nga dëshmia e trashëgimisë ligjore në datën 9.4.2013.

Komisioni bazuar në analizën financiare konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për likuidimin e pronarit për pasurinë e blerë dhe kthimin e huave te subjektet huadhënës.

Lidhur me burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të huadhënësve B.L., S.Sh., dhe D. K., është pyetur subjekti dhe në përgjigje të pyetësorit¹ ka paraqitur shpjegime dhe dokumentacion shkresor.

Komisioni, bazuar në dokumentacionin shkresor të paraqitur (vërtetim për pagimin taksave vendore), arriti në përfundimin se nuk provohet plotësisht mundësia financiare e huadhënësit B.L., për dhënien hua në shumën 2,000,000 lekë.

Sipas shkresës nr. *** prot., datë 13.9.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Tiranë, rezulton se huadhënësi B.L., ka qenë pagues i Taksës së Biznesit të Vogël në masën 25,000 lekë në vit, për periudhën 2009 – 2010 të ndarë sipas 3-mujoreve. Nga ky vërtetim, duke iu referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ky biznes ka patur një xhiro nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit.

Gjithashtu, për vitin 2011 rezultoi se shtetasi B.L., ka paguar detyrimin si biznes i vogël për xhiron nga 2,000,000 lekë deri në 3,000,000 lekë.

Sipas shkresës nr. *** prot., datë 6.9.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve Tiranë, konfirmohet xhiro dhe fitim bruto për vitin 2013 me një normë fitimi të llogaritur, prej rreth 26%. Meqenëse nuk rezultojnë të dhëna të sakta për fitimin në vitet 2009 – 2011, për analogji, duke zbatuar këtë normë fitimi mbi xhiron më të lartë të parashikuar për vitet 2009-2011, Komisioni llogariti paraprakisht një fitim total të vlerësuar neto prej 1,170,000 lekësh. Kjo shumë e llogaritur nga Komisioni dukej që ishte e pamjaftueshme për huadhënien e shumë prej 2,000,000 lekësh në nëntor të vitit 2011 nga z. B.L.

Lidhur me këtë çështje Komisioni kërkoi që subjekti të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke i kërkuar subjektit:

- të sqarojë krijimin e gjendjes *cash* të akumuluar deri në vitin 2011;
- të provojë/vërtetojë të ardhurat dhe mundësitë financiare dhe burimin e ligjshëm të huadhënësit B.L., për dhënien hua të shumë prej 2,000,000 lekësh; si dhe
- t'i kalojë barrën së provës për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 4, të nenit 32, dhe gurmës “b” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe ka paraqitur dokumentacion provues:

- *Shtetasi B.L., prej vitit 2005, ka ushtruar aktivitet në fushën tregtare fillimisht i punësuar si agjent shitjesh pranë firmës “***” sh.p.k., dhe prej muajit shtator të vitit 2009, është*

¹ Shikoni përgjigjen e pyetësorit nr. 2 dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në datën 6.10.2019

regjistruar pranë organeve tatimore si person fizik me NIPT ***, duke hapur aktivitetin e vet privat me objekt "tregti mobilje".

- Shtetasi B.L., njihet me babanë tim S.Sh., ata kanë lidhje miqësore/shoqërore me njëri-tjetrin. Meqenëse ekzistonte kjo lidhje miqësore dhe mundësia ekonomike e zotit B., bashkëshorti im në vitin 2011 për blerjen e apartamentit të ndodhur në Rr. "****", ka marrë hua shumën 2,000,000 lekë prej tij. Arsyeja e marrjes së kësaj huaje ishte pamundësia jonë për të vendosur një pronë si barrë siguruese në bankë, në efekt të marrjes së një kredie, si dhe interesat e larta që bankat aplikonin për kredimarrësit në atë periudhë.
- Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, dhe standardeve kombëtare të kontabilitetit, fitimi i një subjekti tregtar (person fizik) përcaktohet nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës kontabël.² Si rrjedhojë e vet dinamikës së aktivitet tregtar, marzha e fitimi të një subjekti tregtar (person fizik) ndryshon nga një vit në një vit. Kjo për faktin sepse të ardhurat dhe shpenzimet të krahasuara midis viteve në vlera ndryshojnë. Praktika e analizës financiare njeh vetëm krahasimin e zërave të pasqyrave të bilancit dhe rezultatet financiare midis dy viteve të njëpasnjëshëm, por në asnjë rast përcaktimin e rezultatit financiar të një viti duke ju referuar rezultatit financiar të një viti tjetër. Për këtë arsye vlerësimi i fitimit të realizuar nga një subjekt tregtar për vitet 2009, 2010, 2011 nuk mund të bëhet mbi bazën e normës së fitimit të realizuar në vitin 2013.
- Burimet financiare të cilat mund të jepen hua nga një subjekt tregtar (person fizik) nuk janë vetëm fitimet e realizuara gjatë aktivitetit të tij tregtar, por janë të gjitha flukset hyrëse të parasë të gjeneruara gjatë aktivitetit të tij tregtar. Për shembull, parapagimet e bëra për blerje nga klientët, janë flukse hyrëse parash. Pra, gjendja e mjeteve monetare në një subjekt në një datë të caktuar, jo domosdoshmërisht është e lidhur me fitimin e këtij subjekti.
- Shtetasi B.L., në vitin 2009 është regjistruar për herë të parë si person fizik, në kategorinë e biznesit të vogël. Sipas legjislacionit të kohës, bizneset e kësaj kategorie nuk bënin bilanc, sepse detyrimet tatimore që paguante kjo kategori biznesi ishin fikse dhe nuk varehin nga fitimi neto, madje as nga qarkullimi brenda fashës së përcaktuar të xhiros. Kjo kategori i nënshtrohej vetëm pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël mbi qarkullimin e cila ishte fikse, si i tillë ai nuk ka pasur detyrimin që të bëjë bilanc dhe ta dorëzojë atë në zyrat e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Gjatë kësaj kohe, subjekti i është nënshtrohet fushës së zbatimit të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore".
- Referuar shkresës nr. *** prot., datë 28.10.2019, lëshuar nga Bashkia Tiranë vërtetohet se subjekti B.L., me NIPT *** është licencuar në datën 24.9.2009 dhe ka likuiduar detyrimet e parashikuara sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" me ndryshimet përkatëse, si dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 5.2.2007 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" me ndryshimet përkatëse, me situatën si më poshtë:
- Subjekti ka likuiduar detyrimet për taksën e biznesit të vogël, sipas qarkullimit vjetor në nivelet deri në 2,000,000 lekë dhe nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë.

² Sipas ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, periudha kontabël fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor, me përjashtim të rasteve kur subjekti është i sapo krijuar. Në këto raste periudha kontabël fillon në datën e regjistrimit të subjektit dhe mbyllet më datë 31 dhjetor.

- Për periudhat 2009 – 2011 konfirmohet se për subjektin ka vetëm të dhëna në lidhje nivelin e xhiros (qarkullimit) që subjekti ka realizuar gjatë aktivitetit tregtar (2009 – 2011), pasi subjektet me tatim të thjeshtuar nuk kanë pasur detyrim të paraqesin në organin tatimor pasqyra të ardhura dhe shpenzime, pra nuk nxjerrin rezultat financiar dhe nuk shpërndajnë dividend, sipas UMF-së nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe pikave 5 dhe 6 të “vendimit për destinimin e fitimit”. Subjekti nuk ka patur detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit pasardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin³.
- Duke qenë se subjekti nuk ka hartuar dhe deklaruar bilanc për periudhën 2009-2011, unë subjekti i rivlerësimit sot gjendem në pamundësi objektive për të vërtetuar fitimin neto të biznesit të z. B.L., në momentin e dhënies së hua, pasi nuk ka një dokument zyrtar që konfirmon marzhën e fitimit nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të tij për atë periudhë. Bazuar në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se mosparaqitja nga ana e ime e një dokumenti për të vërtetuar fitimin neto të aktivitetit të biznesit të vogël person fizik B. L., është për shkaqe të arsyeshme. Ajo çfarë unë mund të vërtetoj sot është niveli i xhiros (qarkullimit) që subjekti ka realizuar gjatë aktivitetit tregtar për periudhën tetor 2009 – nëntor 2011. Kështu, referuar shkresës nr. *** prot., datë 28.10.2019, lëshuar nga Bashkia Tiranë, vërtetohet se subjekti B.L., i regjistruar me NIPT *** në datën 24.9.2009 për periudhën tetor 2009 – nëntor 2011 ka realizuar një xhiro prej 5.000.000 lekë.
- Përveç të ardhurave nga aktiviteti tregtar, gjatë periudhës dhjetor 2005– tetor 2011 shtetasi B.L., ka përfituar nga produktet e depozitave në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe në “Raiffeisen Bank”⁴ interesa në vlerën prej 1,020,978 lekë. Gjatë periudhës nëntor 2005 – prill 2010, subjekti ka përfituar të ardhura nga pagat në shumën 875, 014 lekë⁵, pra, në tërësi huadhënësi B.L., ka pasur mundësi të dhënies së huasë.
- Për periudhën 2009 – 2011, subjekti tregtar B.L., ka pasur qarkullim total në shumën prej 5,000,000 lekë (për vitin 2011 ky qarkullim, i cili ka tendencë në rritje, ka qenë në shumën 3.000.000 lekë). Duke marr parasysh objektin e veprimtarisë të ushtruar nga shtetasi B.L., atë të tregtimit të mobileve, marzhat e larta të fitimit në këtë sektor, të ardhurat e realizuara nga interesat bankare, të ardhurat nga pagat e tij vlerësoj se me dokumentacionin e renditur më lart dhe paraqitur bashkëlidhur parashtresave të mija, provohet se shtetasi B.L., ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për dhënien hua të shumës 2.000.000 lekë, bashkëshortit tim, z. B. K.. Për sa më sipër, analiza financiare për vitin 2011, duke llogaritur si burim të ligjshëm të ardhurat e huasë të marra nga shtetasi B.L., paraqitet pozitive.

Nga përgjigjet e subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur paraprakisht rezultoi se huadhënësit kanë pasur të ardhura dhe mundësi financiare në momentin e dhënies së huave, në shumat si më poshtë:

- B.L., ka pasur të ardhura në total për vitet 2005-2011, në vlerën 2,999,658 lekë;

³ Shkresë nr. *** prot., datë 6.9.2017, nga DRT-ja Tiranë ndodhur në dosjen e ILDKPKI.

⁴ Shkresë, datë 1.11.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë, datë 1.10.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 29.10.2019, nga ISSH-ja.

- S.Sh., ka pasur të ardhura vetëm për vitin 2011, në vlerën 1,888,866 lekë;
- D.K., ka pasur të ardhura në total për vitet 2008-2011, në vlerën 1,012,972 lekë;
- M.K., ka pasur të ardhura në total për vitet 2005-2011, në vlerën 1,489,010 lekë.

Lidhur me burimin e ligjshëm të huadhënësve, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit arriti të provonte pas rezultateve të hetimit, të ardhurat e ligjshme dhe mundësitë financiare të huadhënësve B.L., S.Sh., D.K., dhe M.K.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për huan e dhënë nga z. B.L., Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të provuar me saktësi fitimin neto të të ardhurave nga biznesi të huadhënësit për vitet 2009 deri 2011 (neni 32.2 i ligjit nr. 84/2016).

	ANALIZA FINANCIARE	2011
I	PASURI	3 437 367
	Diferencë likuiditeti (likuiditeti 31.12.2011 - likuiditeti 31.12.2010)	3 437 367
II	DETYRIME	2 800 000
	Hua nga B.L., për blerje banese	2 000 000
	Hua nga i vëllai M.K., për blerje banese	500 000
	Hua nga i vëllai D.K., për blerje banese	500 000
	Hua nga i vjehri S.Sh., për blerje banese	500 000
	Kapar për blerje banese	-700 000
III	PASURI NETO (I - II)	637 367
IV	TË ARDHURA dokumentuar	1 728 042
	Të ardhura nga puna Daniela Shirka	648 772
	Të ardhura nga puna bashkëshorti B.K.	1 079 270
V	SHPENZIME	588 410
	Shpenzime jetese	409 860
	Shpenzime udhëtimi	65 001
	Shpenzime drita + ujë të apartamentit Rr. “***”, Tiranë, 2009 – 2012	95 949
	Shpenzime transporti Tiranë-Elbasan për periudhën 2003 – 2015	17 600
VI	Analiza dokumentuar (IV - III - V)	502 265

Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e shumës 3,000,000 lekë nga kursimet *cash* të krijuara ndër vite, për blerjen e një pjese të kësaj pasurie. Megjithatë rezultoi se në deklaratat periodike vjetore të pasurisë të dorëzuara në ILDKPKI, të vitit 2011 dhe 2012, subjekti nuk ka deklaruar ndryshimet (pakësimet) e gjendjes *cash* si rezultat i shpenzimeve të kryera për blerjen e kësaj pasurie.

Analiza financiare e pasurisë, apartament me sip. 92 m², ndodhur në Rr. “****”, blerë në vitin 2012

Kursime <i>cash</i> nga pagat 31.12.2011	3 370 000
Hua nga M.K.	500 000
Hua nga D.K.	500 000
Hua nga S.Sh.	500 000
Hua nga B.L.	2 000 000
Totali	6 870 000
Vlera e shtëpisë së paguar	6 440 000

Në përfundim konstatohet se:

Subjekti i rivlerësimit, bazuar sa më sipër, arriti të provonte mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie nga të ardhurat dhe burimet e ligjshme.

- **Autoveturë marka “Renault”, tip “Megane,”** viti i prodhimit 1998, blerë në vitin 2009, në vlerën 430,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Kursimet nga paga.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e DPSHTRR-së.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Ky automjet është blerë nga subjekti me kontratën e datës 2.2.2009, të lidhur pranë noterit publik, me palë shitëse shtetasin A.P., në vlerën 430,000 lekë. Vlera e blerjes është likuiduar, me lidhjen e kontratës, jashtë zyrës noteriale. Për këtë pasuri subjekti është pajisur më pas me certifikatë pronësie. Kjo është konfirmuar dhe nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, pas përgjigjes me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2019, të DPSHTRR-së.

Këtë pasuri subjekti e ka deklaruar saktë dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009: *“Blerje automjeti në shumën 430,000 lekë nga kursimet e pagës ndër vite”.*

Si burim i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat e kursimeve nga paga e subjektit.

Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në total vlerën 700.000 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklarin të saktë dhe se ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin në vitin 2009 me të ardhurat të ligjshme, të deklaruara si gjendje cash.

- **Kursime të ndodhura në llogarinë e pagës së bashkëshortit.** Vlera totale është 1,292,665.22 lekë. Zotëron ½ të kësaj pasurie së bashku me bashkëshortin.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Të ardhura nga paga e bashkëshortit.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen “BKT”-së.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Sipas shkresave nr. *** prot., datë 1.8.2017, dhe nr. *** prot., datë 19.7.2019, të “BKT”-së konfirmohet se bashkëshorti i subjektit disponon llogari në datën 27.1.2017 (datë kur është plotësuar deklarata “Vetting”), me gjendje në vlerën 1,292,655 lekë.

Është konstatuar se në këto llogari bankare janë kryer veprime, bazuar në të ardhurat të krijuara nga marrëdhëniet e punës së bashkëshortit me shoqërinë “****” sh.a.

Kjo llogari dhe ndryshimet e saj ndër vite është deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI nga subjekti të cilat janë vlerësuar nga Komisioni bazuar në analizën financiare.

Në përfundim konstatohet se:

Subjekti ka bërë deklarin të saktë të kësaj llogarie bankare e cila është krijuar nga të ardhurat nga marrëdhëniet e punës së bashkëshortit të subjektit.

- Gjendje në cash në shumën 400,000 lekë, me zotërim ½ pjesë të saj.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Kursime nga paga e subjektit dhe bashkëshortit.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Subjekti ka deklaruar të ardhura dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, çka e justifikon vlerën e deklaruar.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Pakësuar gjendja cash e mbetur në total 400,000 lekë”.

Komisioni pas hartimit të analizës financiare arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimi ka pasur mundësi për krijimin e gjendjes cash në shumën prej 400,000 lekësh.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklarin të saktë për këtë pasuri dhe se ka pasur mundësi financiare për ta krijuar atë me anë të burimit financiar të ligjshëm.

- **Gjendja e llogarisë së pagës së subjektit në datën 21.01.2017,** pranë “Raiffeisen Bank” në shumën 362.58 lekë. Pjesa takuese: ½ .

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur përputhet me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Me shkresat nr. *** prot., datë 21.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 2.7. 2019, “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar se subjekti disponon llogari page me gjendje në vlerën 362 lekë më 27.1.2017

Është konstatuar se në këto llogari bankare janë kryer veprime, bazuar në të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet e punës. Kjo llogari dhe ndryshimet e saj ndër vite janë deklaruar dhe në deklaratat periodike vjetore nga subjekti. Në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni janë pasqyruar ndryshimet e kësaj llogarie bankare, veprimet e kryera dhe mundësitë financiare gjatë gjithë viteve të deklarimit të pasurisë.

Në përfundim konstatohet se :

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri dhe se ka pasur mundësi financiare për ta krijuar atë me anë të burimit financiar të ligjshëm.

- **Depozitë pa afat në “Raiffeisen Bank”** hapur në datën 8.6.2006, në vlerën 437,42 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur përputhet me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Me shkresat nr. *** prot., datë 21.7.2017, dhe nr. *** prot., datë 2.7. 2019, “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, disponon llogari page me gjendje në vlerën 437 lekë në datën 23.1.2017.

Është konstatuar se në këto llogari bankare janë kryer veprime si një llogari kursimi. Kjo llogari dhe ndryshimet e saj ndër vite janë deklaruar dhe në deklaratat periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit. Në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni janë pasqyruar ndryshimet e kësaj llogarie bankare, veprimet e kryera dhe mundësitë financiare gjatë gjithë viteve të deklarimit të pasurisë.

Në përfundim konstatohet se :

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri dhe se ka pasur mundësi financiare për ta krijuar atë me anë të burimit financiar të ligjshëm.

- **Depozitë bono privatizimi të bashkëshortit të subjektit në vlerën 50,000 lekë**, në vitin 2008 pranë drejtorisë së administrimit dhe shitjes së pronave publike, për blerje aksionesh si punonjës pranë kompanisë “****” sh.a.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Kursime nga paga me pjesë takuese 100 %.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Bashkëshorti i subjektit me kontratën nr. ***, datë 1.8.2018, ka shitur aksionet që zotëronte në shoqërinë “****” sh.a.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Për këtë pasuri subjekti ka paraqitur formular për blerje aksionesh në emrin e B.K., me vlerë 50,000 lekë, pranë shoqërisë “****” sh.a., në datën 11.1.2008. Shoqëria “****” sh.a., me vërtetimin nr. ***, në datë. 24.10.2016, ka saktësuar se B.K., ka aksione pranë kësaj shoqërie

më vlerë 0,00033333333%. Këto aksione janë blerë nga bashkëshorti i subjektit si punonjës i shoqërisë “****” sh.a. në periudhën para martesës. Vlera financiare për këto aksione është përfshirë në analizën financiare të hartuar nga Komisioni.

Këtë pasuri subjekti e ka deklaruar dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009: *“Depozituar pranë DASHPP-së vlera prej 125,000 lekë bonoprivatizimi me qëllim blerje aksionesh nga kompania “****”. Nga këto 50,000 lekë në emër të B.K., dhe 75,000 lekë në emër të nënës V.K.”.*

Në datën 1.8.2018 bashkëshorti i subjektit me kontratën nr. ***, ka shitur pjesën disponuese të aksioneve që zotëronte në shoqërinë “****” sh.a.

Bazuar në përgjigjen e Agjencisë së Prokurimit Publik me shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2018, administruar nga dosja e ardhur nga ILDKPKI-ja, rezulton se shoqëria “****” sh.a me NIPT ***, është e regjistruar në sistemin SPE dhe është shpallur fitues në 220 procedura prokurimi elektronik për periudhën deri në datën 27.12.2017.

Arsyetimi ligjor

Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në pikën 1, të nenit 21, përcaktohet: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.*

Në pikën 1, të nenit 24, të po këtij ligji përcaktohet: *“Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”.*

Në interpretim të neneve të sipërcituara rezulton se asnjë shoqëri tregtare, ku gjyqtarët dhe personat e lidhur me të zotërojnë në mënyrë aktive aksione në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike.

Një ndalim i tillë është bërë me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, të ndryshuar’”.* Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 3.6.2014.

Pra, sipas ndryshimeve të ligjit rezulton se çdo kontratë e lidhur me institucione publike nga data 3.6.2014, është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, me ndryshimet përkatëse.

Referuar përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit Publik rezulton se nga viti 2009 deri në vitin 2017, shoqëria “****” sh.a., ku bashkëshorti i subjektit është aksioner i saj, është shpallur fituese dhe ka lidhur në total 245 kontrata me institucione të ndryshme publike.

Në përfundim duket se subjekti ishte në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, të ndryshuar.

Subjektit, lidhur me këto konstatime të Komisionit, iu kërkuan shpjegime në rezultatet e hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se:

- *Bashkëshorti B.K., (para martese) në datën 11.1.2008 ka depozituar, pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike bono privatizimi në vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, bono provatizimi për blerje aksionesh si punonjës pranë kompanisë “***” sh.a.*

- *Personi juridik shoqëria “***” sh.a. vepron në bazë të parimit të pavarësisë pasurore të personit juridik, sipas të cilit pasuritë e saj janë të pavarura nga pasuritë e zotëruesve të kuotave/aksioneve. Për pasojë, arkëtimet që ka bërë shoqëria “***” sh.a. si rezultat i pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik për periudhën deri në datën 27.12.2017, janë shuma që kanë kaluar në pronësi të saj dhe jo të aksionerit B.K.*

- *Nga momenti i fitimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e shoqërisë nga bashkëshorti im, deri në vitin 2018 (kur është realizuar shitja e këtyre aksioneve), nga shoqëria “***” sh.a. është vendosur mos shpërndarja e dividendit. Sqarohet se në asnjë rast bashkëshorti im nuk ka qenë në ndonjë marrëdhënie me këtë shoqëri me cilësinë e aksionerit. Nuk ka marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronik.*

- *Me shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2018⁶, Agjencia e Prokurimit Publik konfirmon se shtetasi B.K., nuk rezulton të ketë lidhur kontratë apo nënkontrata me ndonjë institucion publik. Vlera e aksioneve të zotëruara prej tij është shumë e ulët, vetëm 0.0003333333%. Pavarësisht nga fakti që shoqëria “***” sh.a. ka marrë pjesë në tender apo ka lidhur kontrata, bashkëshorti B.K., nuk ka pasur rol vendimmarrës, duke qenë se vlera e aksioneve ka qenë e papërfillshme dhe për këtë arsye nuk provohet asnjë lloj konflikti interesi. Qenia aksioner në këtë shoqëri, rezulton të qenë tërësisht formale, për efekt të marrëdhënies së punës në momentin e privatizimit.*

- *Me kontratën e shitjes së aksioneve nr. ***, datë 1.8.2018, bashkëshorti im ka hequr dorë nga këto aksione⁷, duke i tjetërsuar ato, duke përjashtuar kështu rrezikun e gjendjes në situatën e konfliktit të interesit të parashikuar në germën “d”, të ligjit nr. 84/2016. Në datën 23.8.2018 kontrata e tjetërsimit është depozituar në QKB dhe janë kryer procedurat e aplikimit për këtë tjetërsim.*

- *Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, nuk gjendet në konflikt interesi, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005’”. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në raste të tjera, ndonëse jo krejtësisht të ngjashme, pasi unë si subjekt nuk kam poseduar asnjëherë aksione⁸.*

Në përfundim konstatohet se:

Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur detyrimin ligjor për shmangien e konfliktit të interesit dhe mosmarrjen pjesë si aksionerë të shoqërisë në prokurime dhe përfitime të fondeve publike. Por, Komisioni vlerëson se vlera e aksioneve prej 0,0003333333%, kanë

⁶ Akt i kërkuar nga ILDKPKI i ndodhur në dosjen e venë në dispozicion subjektit të rivlerësimit.

⁷ Këto aksione janë pasuri vetjake e bashkëshortit para martese.

⁸ Vendim nr. ***, datë 8.7.2019, për subjektin e rivlerësimit, z. Z. H.

qenë të papërfillshme lidhur me vendimmarrjen e bashkëshortit të subjektit në këtë shoqëri. Gjithashtu, rezultoi se shoqëria “****” sh.a. nuk ka shpërndarë dividend dhe se bashkëshorti i subjektit nuk ka përfituar të ardhura nga kjo shoqëri.

- **Lidhur me pasurinë apartament ndodhur në Rr. “****”**

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në përgjigje të pyetësorit 1 dhe në deklaratat e interesave privatë periodike, subjekti, ka deklaruar për periudhën shtator 2009 - janar 2012 si adresë banimi: Rr. “****”, pranë restorant ****, me adresar të ri: Rr. “****”, Tiranë.

Lidhur me përdorimin e kësaj adrese subjekti ka deklaruar:

- Në përgjigje të pyetësorit 1 kam deklaruar se: “Kam përdorur apartamentin me adresë rruga “****” nr. ***, ap. ***, në bashkëpronësi të shtetasve G.Sh., N.B., dhe S.Z., në të cilin kam jetuar pas lidhjes së martesës, nga muaji shtator 2009 deri në fund të muajit janar 2012”.

- Në referim të kësaj pyetje të drejtuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit sqaroj se bashkëpronarët e këtij apartamenti, nëpërmjet deklaratave të përpiluara përpara noterit shprehin vullnetin e tyre në lidhje me statusin e banimit në këtë banesë, të dhënat në lidhje pasurinë dhe burimet e krijimit të saj. Sipas përmbajtjes së deklaratave, kjo banesë i është lënë në përdorim pa qira nënës së bashkëshortin tim e cila ka jetuar aty prej muajit nëntor 2003 e në vazhdim me dy djemtë e saj D., dhe B.

- Unë kam jetuar në këtë banesë pas lidhjes së martesës. Për periudhën që kemi jetuar kemi paguar faturat përkatëse të energjisë elektrike dhe ujit. Në një vlerë mesatare shpenzimet e kryera kanë qenë afërsisht në shumën 7,000 (shtatë mijë) lekë në muaj. Të ndara ndër vite shpenzimet janë të shprehur në faturat e KESH-it dhe të UKT-së.

Për të provuar deklaratimet subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 1.10.2019 të shtetasit G.Sh., si bashkëpronar i pasurisë që ndodhet në Rr. “****” dhe që deklaroi se kjo pasuri është përdorur nga subjekti dhe bashkëshorti.

Bazuar në këtë deklaratë pas hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi:

- Kjo pasuri është ndërtuar në vitin 2003 dhe është aplikuar për legalizim në vitin 2005;
- Pasuria është krijuar nga bashkëpronarët G.Sh., N.B., dhe I.Z., nga të ardhurat nga emigracioni, aktiviteti privat, paga nga punësimi dhe kursimet ndër vite;
- Me miratimin e të 3 bashkëpronarëve kjo pasuri apartament i është dhënë në përdorim V.K., dhe 2 djemve të saj B., dhe D.K., për të jetuar duke filluar nga muaji nëntor 2003 (me V.K., kanë pasur lidhje të ngushta familjare).
- B.K., dhe D.Sh., kanë qëndruar në këtë apartament deri në muajin janar 2012; nga Shtatori 2009, pa paguar qira;
- Gjatë qëndrimit subjekti dhe bashkëshorti kanë paguar detyrimet me shpenzimet e veta, ndaj palëve të treta, kontrata që kanë qenë në emër të z. N.B.

Rezultoi se të njëjta deklarata kanë bërë dhe bashkëpronarët e tjerë S.Z., (deklarata noteriale nr. ***, datë 1.10.2019) dhe N.B., (deklarata e datës 2.10.2019).

Në përfundim konstatohet se:

Lidhur me këtë pasuri dhe deklaratimet e bëra nga subjekti Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë, pasi rezultoi se përdorimi i kësaj pasurie është bërë nga bashkëshorti i subjektit dhe familja e tij para martesës.

- Lidhur me përdorimin e automjeteve

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në lidhje me përdorimin e automjeteve për udhëtime nga subjekti dhe personat e lidhur është deklaruar se:

*“Për udhëtime kemi përdorur makinën me targa TR ***, e cila është në pronësinë time.*

*Për udhëtimet jashtë vendit në datat 29.5.2010 dhe 8.6.2016 (udhëtime brenda ditës në Kosovë), bashkëshorti B. K., ka udhëtuar si pasagjer me makinat me targa TR *** (datë 29.5.2010) dhe AA *** (datë 8.6.2016).*

*Makina me targa TR *** është në pronësi të shtetasit A.S., dhe makina me targa AA ***, është në pronësi të shtetasit L.K. Shtetasit A.S., dhe L.K., në kohën kur janë realizuar këto udhëtime kanë qenë koleg pune me bashkëshortin, ata kanë qenë në marrëdhënie pune në kompaninë “***” sh.a. Bashkëlidhur paraqes vërtetimet me nr. *** prot., datë 26.9.2019, dhe nr. *** prot., datë 26.9.2019, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë.*

Në përfundim konstatohet se:

Lidhur me këtë deklaratim Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë.

ANALIZA FINACIARE

	I	II	III	IV = (II-III)	V	VI = I -IV - V
VITI	Te ardhura	Pasuria	Detyrime	Pasuria neto	Shpenzime	Rezultati
2003	362 462	0	0	0	111 564	250 898
2004	805 086	0	0	0	199 564	605 522
2005	841 446	453	0	453	215 157	625 836
2006	810 851	200 414	0	200 414	298 038	312 399
2007	823 790	299 711	0	299 711	242 220	281 859
2008	806 371	209 918	0	209 918	242 220	354 233
2009	3 311 453	2 070 425	0	2 070 425	588 807	652 221
2010	1 585 193	564 637	0	564 637	509 297	511 259
2011	1 728 042	3 437 367	2 800 000	637 367	588 410	502 265
2012	2 126 978	1 797 718	700 000	1 097 718	680 026	349 234
2013	2 501 015	-1 109 851	-2 000 000	890 149	753 211	857 656
2014	2 732 418	-248 794	-1 000 000	751 206	1 007 594	973 618
2015	3 042 977	642 728	-500 000	1 142 728	1 038 428	861 821
2016	3 200 983	784 900	0	784 900	1 104 650	1 311 433
TOTAL	24 679 064	8 649 625		8 649 625	7 579 185	

- Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni, është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “Credins Bank”, “Tirana Bank”, “Raiffeisen Bank”, “BKT”, “ABI Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

(i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Shkollën e Magjistraturës(bursë) për periudhën 2001 – 2003; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën 2003 – 2015; Gjykatën Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë për periudhën 2014-2016.

(ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortit së subjektit në kompaninë “****” sh.a., për periudhën 1999 – 2016; nga shpronësimi i tokës arë, në vitin 2013,në Kodovjat, Gramsh.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

(i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);

(ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur, duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Në rastet kur qëndrimi është deklaruar tek familjaret e subjektit/ bashkëshortit, janë llogaritur shpenzimin e udhëtimit si më lart si dhe kosto qëndrimi 20 euro/ditë). Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ bashkëshorti kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

Për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit jashtë Republikës së Shqipërisë, subjekti ka sjellë disa dokumente, që vërtetojnë se disa nga udhëtimet kanë qenë për shkaqe pune dhe shpenzimet e tyre kanë qenë të mbuluara nga organizatorët. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorëve subjekti i rivlerësimit ka sjellë edhe faturën e agjencisë së udhëtimit që vërteton koston e një pakete turistike të blerë në vitin 2013.

(iii) Shpenzime arredimi, arsimim fëmijësh të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni.

(iv) Shpenzime transporti për vitet e punës në Elbasan, pasi për periudhën 2004 – 2015, subjekti ka qenë me banim në Tiranë dhe ka ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

- Për periudhën 21.10.2003 deri 14.7.2015, subjekti i rivlerësimit ka punuar si gjykatëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Për sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të transportit Tiranë – Elbasan dhe anasjelltas është marrë parasysh shpjegimi i subjektit:

“...për të udhëtuar për në qytetin e Elbasanit kam përdorur gjithmonë transportin publik⁹. Analiza financiare për vitin 2011 e përgatitur nga Komisioni, mendoj se duhet të reflektojë ndryshimet e lartpërmendura...”

Gjithashtu, subjekti ka sjellë edhe një vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan të datës 29.10.2019, sipas të cilit, znj. Daniela Shirka, gjatë periudhës 1.11.2010 – 23.10.2011 ka qenë me leje lindje. Si rrjedhim i kësaj për periudhën në fjalë nuk janë llogaritur shpenzime transporti Tiranë – Elbasan dhe anasjelltas.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁰.

d. Në vlerën e huave të marra për blerjen e apartamentit në vitin 2011 dhe të kthyera huadhënësve në vitet 2013 – 2015.

Analiza financiare e hartuar nga Komisioni është bërë duke llogaritur si burim të ligjshëm të ardhurat nga huaja e marrë nga shtetasit B.L., S.Sh., D.K., dhe M.K., pasi subjekti arriti të provojë mundësinë financiare dhe burimin e ligjshëm të huadhënësve.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni, bazuar në analizën financiare, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi dhe burime financiare të ligjshme, për vitet 2008-2016, në të cilat ka ushtruar funksionet e prokurores.

Nga administrimi i shkresave dhe provave të tjera që ndodhen në dosjen e Komisionit lidhur me hetimin e kryer, nuk rezultuan indicie lidhur me vlerësime të fakteve dhe rrethanave të tjera për kriterin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2019, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 29.10.2019, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: ***“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka”***.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional të subjektit Daniela Shirka është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të

⁹ Për llogaritja e çmimeve në lidhje me kostot e këtij transporti bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në VKM-në nr. 4, datë 10.1.1994 dhe VKM-në nr. 146, datë 26.2.1998, të cilat përcaktojnë vlerën e tarifave të transportit të udhëtarëve. Ky rregullim ligjor ka ekzistuar deri në vitin 2015

¹⁰ Shiko kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport është hartuar, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të 3(tre) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) Pesë dosje/praktika penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ-së.

Raporti është kontrolluar dhe vlerësuar nga relatori i cili e ka paraqitur përpara trupit gjykues së Komisionit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Daniela Shirka.

Vlerësimi për pesë dosjet e përzgjedhura me short

- **Dosja 1.** Çështja penale nr. *** regj. them., datë regjistrimi 18.12.2015, kërkesa e Prokurorisë së Krimeve të Rënda me objekt: “sekuestrim dhe marrje e të dhënave kompjuterike”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 19.12.2015

Çështja u regjistrua në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në datën 18.12.2015, ora 15:00, dhe i ka kaluar për gjykim menjëherë gjyqtares Daniela Shirka.

Gjyqtarja me vendim të ndërmjetëm në datën 19.12.2015, ora 9:50, me bazë ligjore të cituar ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, është tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar dhe në kthim ka shpallur dispozitivin e vendimit.

Ndaj vendimit të mësipërm nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtare Daniela Shirka janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në datën 24.12.2015, brenda 5 ditëve nga shpallja, në zbatim të afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 1 ditë, në intervalin kohor 18.12.2015 – 19.12.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit ligjor të përcaktuar nga pika 2, e neni 208/a, të Kodit të Procedurës Penale.

Konstatohet një menaxhim korrekt i çështjes nga gjyqtarja Daniela Shirka, e cila ka kryer veprimet e duhura procedurale për zgjidhjen e çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta.

Vendimi përmban elementët e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e vendimit

Vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Në vendim janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi është i kuptueshëm dhe i qartë.

- **Dosja 2.** Çështja civile nr. *** regj. them., datë regjistrimi 11.09.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës E.T., kundër të paditurit A. T., me objekt: “zgjidhje martesë”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.12.2014

Çështja u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 10.9.2014 dhe me shortin elektronik të datës 11.9.2014, iu caktua gjyqtares Daniela Shirka.

Gjyqtarja u tërhoq në dhomën e këshillimit në datën 5.12.2014. Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 10.12.2014, brenda 5 ditëve nga shpallja, në zbatim të afatit 10 ditor të parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 308, i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 2 muaj e 24 ditë, në intervalin kohor 11.9.2014 – 5.12.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga germa “d”, e pikës 5, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Konstatohet se gjyqtare Daniela Shirka ka menaxhuar shumë mirë procesin gjyqësor të sipërcituar. Të gjitha seancat janë planifikuar nën afatin 30 ditor.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 5.12.2014, është dhënë nga gjyqtarja Daniela Shirka, në cilësinë e gjyqtares së vetme. Vendimi përmban elementët e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e .

Nga pikëpamja formale, vendimi paraqitet i organizuar dhe me strukturë të qëndrueshme. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi është i kuptueshëm dhe i qartë.

- **Dosja 3.** Çështja civile nr. *** regj. them., datë regjistrimi 9.10.2014, me palë ndërgjyqëse: paditës Z. L., kundër të paditurës V.L., me objekt të padisë: “zgjidhje martese”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 9.12.2014.

Çështja u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 8.10.2014 dhe me shortin elektronik të datës 9.10.2014, iu caktua gjyqtares Daniela Shirka.

Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 11.12.2014, brenda 2 ditëve nga shpallja, në zbatim të afatit 10 ditor të parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 308, i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 2 muaj, në intervalin kohor 9.10.2014 – 9.12.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga germa “d”, e pikës 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor, i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Konstatohet se gjyqtare Daniela Shirka ka menaxhuar shumë mirë procesin gjyqësor të sipërcituar.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 9.12.2014 është dhënë nga gjyqtarja Daniela Shirka, në cilësinë e gjyqtares së vetme. Vendimi përmban elementët e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e vendimt.

- **Dosja 4.** Çështja civile nr. *** regj. them., datë regjistrimi 14.11.2013, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse O.B., kundër të paditurit A.Ç., me objekt të padisë: “ndryshimin e vendimit civil nr. ***, datë 20.2.2009, për sa i përket masës së pensionit”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.3.2014.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 13.11.2013 dhe me shortin elektronik të datës 14.11.2013, iu caktua gjyqtarës Daniela Shirka.

Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 13.3.2014, brenda 3 ditëve nga shpallja, në zbatim të afatit 10 ditor të parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 308, i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithësej 3 muaj e 24 ditë, në intervalin kohor 14.11.2013 – 10.3.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga germa “d”, e pikës 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Konstatohet se gjyqtare Daniela Shirka e ka menaxhuar shumë mirë procesin gjyqësor. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar, nuk konstatohen të meta. Në dosje janë përfshirë rregullisht padia dhe aktet provuese të saj, vendimi për caktimin e seancës përgatitore, vendimi për kalimin e çështjes në gjykim, aktet e njoftimit, procesverbali i seancave përgatitore dhe ai i seancave gjyqësore, provat shkresore, vendimi gjyqësor përfundimtar.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 10.3.2014, është dhënë nga gjyqtarja Daniela Shirka, në cilësinë e gjyqtarës së vetme. Vendimi përmban elementët e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e vendimit

Nga pikëpamja formale vendimi paraqitet me strukturë të organizuar. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimimit dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm.

- **Dosja 5.** Çështja civile nr. *** regj. them., datë regjistrimi 22.10.2013, që ju përket palëve ndërgjyqëse: paditës B. Q., kundër të paditurës V. Q., me objekt të padisë: “zgjdhje martesë dhe lënien e fëmijës për rritje dhe për edukim të paditurës, si dhe caktim pensioni ushqimor”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 19.12.2013.

Çështja u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 18.10.2013 dhe me shortin elektronik të datës 21.10.2013, iu caktua gjyqtarës Daniela Shirka.

Kundër vendimit ka ushtruar ankim paditësi. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 6.7.2015, ka vendosur: “*mospranim ankimi*”, për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtare Daniela Shirka, janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 23.12.2013, brenda 4 ditëve nga shpallja, në zbatim të afatit 10 ditor të parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 308, i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 muaj e 27 ditë, në intervalin kohor 22.10.2013 – 19.12.2013. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga germa “d”, e pikës 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Konstatohet se gjyqtare Daniela Shirka ka menaxhuar shumë mirë procesin gjyqësor të sipërcituar. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar, nuk konstatohen të meta. Në dosje janë

përfshirë rregullisht padia dhe aktet provuese të saj, vendimi për caktimin e seancës së pajtimit dhe aktet e njoftimit, procesverbali i seancës së pajtimit dhe ai i seancave gjyqësore, provat shkresore, vendimi gjyqësor përfundimtar. Gjyqtarja ka disponuar edhe me vendim formal për kalimin e çështjes në gjykim. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale. Procesverbali gjyqësor nga ana formale përmbush kriteret e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i nënshkruar rregullisht. Vendimet e ndërmjetme në çdo rast tregojnë shkakun ligjor. Dosja është e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 19.12.2013, është dhënë nga gjyqtarja Daniela Shirka, në cilësinë e gjyqtare së vetme. Vendimi përmban elementët e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e vendimit

Nga pikëpamja formale, vendimi paraqitet me strukturë të organizuar. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe janë përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi është i qartë, i kuptueshëm dhe i argumentuar.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Daniela Shirka ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.2001 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2004. Pas studimeve, më 16.9.2004, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në vijim, më 14.7.2015, gjyqtarja Daniela Shirka emërohet gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Daniela Shirka është paraqitur 1 ankesë (në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së.

Ankesa e paraqitur në vitin 2015 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Daniela Shirka përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E GJETJEVE

Gjyqtare Daniela Shirka ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dosja penale e vëzhguar konfirmon njohuri procedurale të gjyqtare mbi mjetet e kërkimit të provës gjatë fazës së hetimeve paraprake. Katër dosjet gjyqësore civile të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj mbi të drejtën familjare për shkak se në periudhën e rivlerësimit gjyqtarja ka qenë pjesë e seksionit familjar të dhomës civile.

Përzgjedhja e vendimeve të paraqitura nga subjekti është e tillë që referon në gjykime për vepra penale të ndryshme, në gjykime me procedurë të zakonshme ashtu dhe atë të shkurtuar, duke konfirmuar njohuritë në shumëllojshmërinë e veprave penale në kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda : trafikimi personi; shfrytëzim prostitucioni; prodhim dhe

mbajtje pa lejë e armëve të ftohta; prodhimi dhe mbajtja pa lejë e armëve luftarake dhe municionit; trafikim narkotikësh; dhe shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie. Këto vendime konfirmojnë gjithashtu njohuri të gjyqtarës në institute të ndryshme të pjesës së përgjithshme të së drejtës penale si: grupi i strukturuar kriminal si formë e vecantë e bashkëpunimit, gjykimi i shkurtuar, rregullat për caktimin e dënimit përfshi bashkimin e dënimeve.

Në funksion të zbatimit të ligjit gjyqtarja përdor referenca në *jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë*. Gjyqtarja gjatë arsyetimit të vendimeve referon edhe në akte ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi procedurale, ndjek procedurën e parashikuar nga ligji, duke disponuar në çdo rast me vendime të ndërmjetme të cilat paraqiten të arsyetuara dhe përmbajnë bazë ligjore të shprehur. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar mangësi në njohuritë procedurale penale, civile apo familjare të gjyqtarës.

Ndër pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara rezulton se vetëm 1 vendim është ankimuar. Në këtë rast Gjykata e Apelit ka vendosur “mospranim ankimi” për shkak të paraqitjes së tij tej afatit ligjor. Nuk rezultojnë vendime të rekursuara në Gjykatë të Lartë.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi. Dy nga tre vendimet penale të themelit janë të organizuar sipas një strukture ku vendimi ndahet në pjesë: me nënndarje: pretendimet në gjykim; rrethanat e faktit; dhe arsyetimi ligjor (shih dokumentet 1 dhe 2). Në dokumentin nr. 1 strukturimi i vendimit për çdo çështje të marrë në analizë dhe për çdo të pandehur nga njëra anë e bën të kuptueshëm atë çfarë ka vlerësuar dhe konkluduar gjykata në atë pjesë, ndërsa e parë në tërësi me ndarjet, apo nëndarjet e tjera krijon vështirësi për të kuptuar logjikën në tërësi. Listohet me paragraf çdo provë e marrë në shqyrtim, çfarë e ngarkon leximin e këtij vendimi i cili paraqitet voluminoz.

Në dokumentin nr. 3 gjyqtarja përdor sërish metodën e strukturimit të vendimit për çdo çështje të marrë në analizë, vendim i cili paraqitet gjithashtu voluminoz kjo edhe për shkak të numrit të të pandehurve.

Gjyqtarja tregon kujdes për të marrë në shqyrtim çdo episod të veprës penale duke çmuar dhe vlerësuar edhe provat respektive për secilin të pandehur në këndvështrim të parashikimeve ligjore, si dhe praktikës unifikuese për rastin në gjykim. Karakteristike është arsyetimi në paragrafë më vete për caktimin e dënimit, provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore.

Në pesë dosjet e vëzhguara vendimi përfundimtar paraqitet gjithashtu i organizuar me strukturë ku vendimi ndahet në pjesë: rrethanat e çështjes; dhe arsyetimi ligjor. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me objektin e mosmarrëveshjes. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Ajo tregon normën ligjore që zbatohet për faktin e mosmarrëveshjes, të përcaktuar sipas provave të shqyrtuara.

Nga pikëpamja formale, vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal apo kërkesat e legjislacionit procedural civil.

Gjyqtarja bën pjesë të arsyetimit në arsyetimin e vendimit përfundimtar edhe të vendimeve të ndërmjetme të gjykatës mbi kërkesat paraprake të palëve mbi aplikimin e gjyqimit të shkurtuar apo kërkesave të tjera procedurale, apo mënyrën e njoftimit të palëve.

Karakteristikë e gjyqtarës në gjykimin e çështjeve, ku trajtohen dhe të drejtat e të miturve, është përcaktimi me vendim të ndërmjetëm i detyrave shumë të qarta për psikologun, duke e orientuar atë për t'u shprehur mbi gjendjen, marrëdhëniet, cilësitë dhe aftësitë e palëve ndërgjyqëse të cilat duhet të vëzhgohen, duke pasur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Caktimi i këtyre detyrave për ekspertin e fushës dhe marrja e mendimit të tij, ndihmojnë gjykatën për të disponuar në interesin më të lartë të fëmijës në zbatim të nenit 6 të Kodit të Familjes.

Gjithashtu, te të pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke cituar në çdo rast bazën ligjore përkatëse.

Lidhur me ngarkesën sasiore, për periudhën 2014 – 2016, gjyqtare Daniela Shirka ka deklaruar të dhëna statistikore duke iu referuar të dhënave të pasqyruara në shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 17.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan sipas të cilës në këtë gjykatë i janë caktuar 1686 çështje dhe ka përfunduar 1706, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë i janë caktuar 145 dhe ka përfunduar 137, ndërsa për vitin 2017 ka mbartur 3 çështje penale. Bazuar në këto të dhëna rendimenti i përfundimit të çështjeve është 105.5 %.

Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për një periudhë 1 vit e 9 muaj dhe 6 ditë: 8.10.2013 – 14.7.2015, konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin sasior.

Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për një periudhë 1 vit e 2 muaj dhe 24 ditë: 14.7.2015 – 8.10.2016, konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë nën standardin sasior.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtare Daniela Shirka ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë deri në 3 muaj dhe 24 ditë. Kohëzgjatja e gjykimit te të pesë dosjet e vëzhguara rezulton të jetë brenda afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve, si dhe afateve procedurale penale për gjykimin e kërkesave të ngutshme referuar paragrafi 2, të nenit 208/a, të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, është efektive në përfundimin në kohë të shpejtë dhe pa vonesa të gjykimeve, që është tregues i lidhur me aftësitë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim.

Të gjitha seancat rezultojnë të kenë filluar në orarin e planifikuar nga gjyqtarja në respektim të nenit 4 të vendimit nr. 238/1/b, datë 24.12.2008, të KLD-së “ për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”, sipas të cilit “*proceset gjyqësore duhet të fillojnë në respektim të orarit të gjykimit të komunikuar dhe të afishuar në gjykatë, me përjashtim të rasteve kur ka një arsye të justifikuar*”.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën, vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në të pesë dosjet gjyqësore janë përfshirë rregullisht: padia dhe provat e paraqitura nga paditësi në procesin civil apo kërkesa për gjykim provat përkatëse; vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës së parë përgatitore apo të pajtimit; aktet e njoftimit të palëve; kërkesat me shkrim të palëve dhe provat e paraqitura prej tyre;

procesverbali përgatitor, i pajtimit dhe ai gjyqësor; si dhe parashtrimet e palëve dhe vendimi gjyqësor.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, dhe nga të pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, për shkak të funksionit që kryen, i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 17 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 28 ditë trajnim gjithësej, ndërsa është certifikuar në 17 raste, për shkak se në një trajnim ka marrë pjesë vetëm 1 ditë. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë në gjykimin e çështjeve civile apo penale, si dhe në gjykimin e çështjeve në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Në përfundim, Komisioni, nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional për pesë çështjet e shortuara për subjektin e rivlerësimit dhe informacioni i marrë nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Trupa gjyqësore nuk gjeti asnjë indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e magjistratit.

Çështja gjyqësore e vitit 2007

Komisioni, lidhur me një çështje gjyqësore të ndjekur nga subjekti në vitin 2007, bëri një hetim administrativ. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2019, Komisioni kërkoi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dosjen gjyqësore lidhur me shtetasin Xh.I., i akuzuar në vitin 2007, për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”. Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2019, ka dërguar në Komision dosjen gjyqësore me palë të pandehur Xh.I.

Nga kjo dosje rezultoi se me vendimin nr. ***, datë 3.7.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupit gjykues, ka shqyrtuar çështjen penale nr. *** akti, me palë të pandehur Xh.I., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, në formën e vrasjes kundër 3 personave mbetur në fazën e tentativës. Në përfundim prokuroria ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij me tetë vjet burgim. Gjykata në përfundim të procesit ka vendosur:

- T’i japë faktit në ngarkim të të pandehurit një përcaktim të ndryshëm nga përcaktimi i prokurorit;
- Të pandehurit t’i atribuohet kryerja e veprës penale “plagosja e lehtë me dashje”, të kryer tre herë;
- Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit, për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, për shkak se është dhënë amnisti;

- Heqjen e masës “arrest në burg” dhe urdhërohet lirimi i të pandehurit për efekt të kësaj çështje.

Gjykata e Apelit Durrës, pas ankimit të bërë nga Prokuroria, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 3.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke e deklaruar të pandehurin fajtor për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese, kundër tre personave, të ngelur në tentativë dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim”;
- Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi.

Gjykata e Lartë ka vendosur:

- Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Xh.I., ndaj vendimit nr. ***, datë 21.1.2009, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Pra, Komisioni, konstatoi se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë shfuqizuar vendimin e marrë nga trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupit gjykues), dhe duke e dënuar të pandehurin Xh. I., përfundimisht me 8 vjet burg, për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese kundër tre personave, të mbetur në tentativë”.

Lidhur me këto konstatime të Komisionit iu kërkua subjektit të jepte shpjegime mbi veprimet dhe arsyetimin e saj lidhur me këtë rast/çështje, e cila në përgjigje të rezultateve të hetimit deklaroi:

- Së pari, pasi u njoha me kopjen e akteve që kanë të bëjnë me këtë dosje gjyqësore, konstatoj se në vendimin e saj, nga Gjykata e Apelit Durrës, nuk evidentohen shkelje të normave urdhëruese procedurale apo mosarsyetim i vendimit gjyqësor. Disponimi i Gjykatës së Apelit Durrës, lidhet me mënyrën e vlerësimit të provave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe vetëm për zgjidhjen e çështjes në themel. Cenimi/ndryshimi i vendimit nga Gjykata e Apelit, ka ardhur si rrjedhojë e një vlerësimi të ndryshëm të fakteve dhe të rrethanave, në lidhje me faktin penal të atribuuar të pandehurit Xh. I., duke konkluduar në një cilësim juridik të ndryshëm.

- Në mbështetje të standardeve ndërkombëtare që garantojnë pavarësinë e jashtme dhe të brendshme të gjyqtarit, shpreh vlerësimin tim që vendimet e cenuara për shkak të vlerësimit të ndryshëm të fakteve, rrethanave apo të provave nga gjykatat më të larta, nuk përbëjnë shkak për përgjegjësi disiplinore.

- Së dyti, nisur nga koha e gjatë që ka kaluar, me ndershmëri, Ju pohoj se për të shpjeguar sa kërkoni në raport, verifikova të gjitha aktet e dosjes, duke ballafaquar rrethanat e çështjes konkrete, me provat dhe ligjin. Më lejoni të theksoj se, në çdo rast vendimmarrja ime/vota ime në rastet e gjykimeve me trup gjykues, ka qenë duke u bazuar në analizën e detajuar të rrethanave, provave dhe akteve në ngarkim të pandehurit.

- Në lidhje me rastin konkret konstatoj se, konkluzioni i arritur është rezultat i analizës së detajuar të provave dhe akteve të ekspertimeve mjeko-ligjore, të vlerësuara ngushtësisht edhe me dëshmitë e marra në këtë proces penal. Ajo që tërheq vëmendjen time është edhe qëndrimi i organit të akuzës, që ndonëse i ka atribuuar të pandehurit kryerjen e një vepre penale të rëndë, në përfundim ka kërkuar dënimin e tij, nën minimumin e përcaktuar në ligj nga dispozita penale konkret, që parashikon një dënim me burgim në minimum 20 vjet. Fakti që organi i

akuzës ka kërkuar që në përfundim i pandehuri të dënohet me 8 vjet burgim, do të thotë që në vlerësim të nenit 23 të Kodit Penal, afërsia e ardhjes së pasojës ka qenë e largët. Fakt është që sipas akteve të ekspertimeve mjeko-ligjore (nr. 211, 212, 213 administruar në dosje), dëmtimet e konstatuara tek të dëmtuarit, sipas ligjit, hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të lehta, duke u cilësuar nga ligji penal pikërisht si “plagosje e lehtë”.

- Në vlerësimin tim, ajo që ndan arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, nga argumentimi i Gjykatës së Apelit, është pikërisht qëllimi që ka patur i pandehuri. Nisur nga rrethanat e çështjes; nga fakti që i pandehuri ka përdorur saçme zogjsh, ndërkohë që dispononte edhe municion tjetër (sipas deklarimeve të dhëna prej tij, dokumentuar në faqen 157 të procesverbalit të seancës gjyqësore); fakti që në follenë e fishekut të armës së gjahut të përdorur prej të pandehurit kishte edhe një fishek arme gjahu (të pa përdorur), e megjithatë i pandehuri nuk e përdori më fishekun e kësaj arme në drejtim të të dëmtuarve; distanca e tij nga të dëmtuarit, e cila nuk ishte shumë e largët, e nëse qëllimi i tij ishte vrasja e tyre, mund ta realizonte, meqë i pandehuri kishte njohuri të mira në përdorimin e armëve të gjahut; - janë veprime që sipas bindjes time, të bazuar në ligj e në prova, tregojnë se i pandehuri, nuk kishte si qëllim vrasjen e të dëmtuarve.

- Së treti, në lidhje me këtë dosje gjyqësore, që konstatoj se është jashtë periudhës së vlerësimit për aftësitë profesionale, nga aktet që i përkasin dosjes së rivlerësimit tim kalimtar, duke ballafaquar aktet që lidhen me verifikimin e kësaj çështje gjyqësore nga ana Juaj, unë nuk konstatoj se ka ndonjë ankim apo denoncim në lidhje me mua si subjekt i rivlerësimit, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, më lejoni të theksoj faktin se, pika ‘4’ e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016 lejon vlerësimin e aftësive profesionale, në rast se ju dispononi informacione në lidhje me etikën dhe aftësitë e mia profesionale. Në këtë vështrim, duke mos e njohur përmbajtjen e këtij informacioni që ju dispononi në lidhje me subjektin tim, ajo që dua të theksoj, është fakti që gjatë gjithë karrierës time profesionale, kam zbatuar me përpikëri Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë, me integritet të lartë moral dhe profesional. Në çdo proces gjyqësor kam respektuar maksimalisht edhe standardet ndërkombëtare në funksion të realizimit të një procesi të drejtë ligjor. Kjo është arsyeja që, në nisje të këtyre shpjegimeve, theksova pikërisht standardin ndërkombëtar të respektimit të pavarësisë së brendshme të gjyqtarit, në dhënien e një vendimi sipas bindjes së tij të krijuar mbi bazën e analizës së provave në raport me rrethanat e çështjes/faktin dhe ligjin e zbatueshëm.

- Parimin e pavarësisë së brendshme të gjyqësorit e kam vlerësuar gjithmonë të lidhur ngushtë me pavarësinë e secilit gjyqtar individual gjatë ushtrimit të funksioneve të tij në gjykimin e çështjeve konkrete.

- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të KE-së (2010)12 thekson se në marrjen e vendimit gjyqtari duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe i aftë për të marrë vendime pa asnjë ndikim, presion, kërcënim apo ndërhyrje, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga çdo autoritet, duke përfshirë edhe autoritetet e brendshme të gjyqësorit. Organizimi i sistemit gjyqësor, në shkallë të ndryshme brenda gjyqësorit, nuk duhet të cenojë pavarësinë individuale të secilit gjyqtar.¹¹ Edhe në Shqipëri pavarësia e gjyqësorit, e jashtme dhe e brendshme, garantohet nga Kushtetuta. Në nenin 145 të Kushtetutës thuhet shprehimisht: “1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”. Natyrisht që, në bindjen time garantimi i

¹¹ Rekomandation CM/Rec (2010)12, (pika 22-25 të tij)

pavarësisë së gjyqësorit dhe paanshmëria e gjyqtarit, nuk mund të nënkuptojë faktin që gjyqtari nuk mban përgjegjësi për punën e kryer gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Por, vlerësimi i performancës së gjyqtarit duhet të arrihet përmes llogaridhënies dhe rritjes së përgjegjshmërisë së tij, në raport me ligjin dhe respektimin e të drejtave kushtetuese të individit.

- Vlerësoma të rëndësishme të trajtoj sa më lart, pasi çmoj të theksoj edhe një herë se, cenimi i një vendimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, për më tepër, kur ka të bëjë me vlerësimin e ndryshëm të provave, nuk mund të vërë në dyshim aftësitë e mia profesionale dhe integritetin tim.

Shpjegimet e subjektit nga Komisioni u konsideruan bindëse dhe se nuk rezultuan indicie që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e magjistratit lidhur me këtë çështje gjyqësore.

DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, janë paraqitur dy denoncime si më poshtë:

1. Denoncim i z. B.K., protokolluar me shkresën nr. ***, datë 12.2.2018, në Komisionin i cili denoncon ndër të tjerë edhe subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore.
2. Denoncim i z. Sh.H., protokolluar me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2018, në Komisionin i cili denoncon ndër të tjerë edhe subjektin e rivlerësimit për paaftësi.

Lidhur me këto denoncime, Komisioni, arriti në përfundimin se nuk ekzistojnë indicie për vlerësim profesional të subjektit.

Në përfundim:

Mbështetur në raportin e vlerësimit profesional për çështjet e shortuara dhe denoncimet e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

Në vlerësimin lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, nuk rezultoi të jetë gjetur ndonjë problem mjaftueshëm i rëndësishëm që do çonte në një vlerësim aftësish profesionale më pak ose ndryshe nga ai “i përshtatshëm” sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, Komisioni, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe interesave private, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Ajo nuk është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, të saj. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, për kriterin e

vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*), dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare.

Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të gurmës c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gurmës “a”, pika 1, të nenit 58, dhe të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Shirka, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 8.11.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona Sanxhaktari
Kryesues

Genta Tafa (Bungo)
Anëtar

Roland Ilia
Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore